



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1045/1 Prot.

Tiranë, më 28.03.2023

VENDIM

Nr. 22, datë 28.03.2023

“PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN 2023, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 44 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit 10926 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, gjurmës “a” të pikës 72, të kapitullit “Rishpërndarja e fondeve buxhetore” të udhëzimit standart nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të buxhetit”, gjurmës a, të pikës 2 të nenit 49 “Rishpërndarja” të rregullores së brendshme të ndryshuar “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në Universitetin e Mjekësisë. Tiranë”, VKM-së nr.386 datë 01.06.2022 “Për miratimin e fushave dhe programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, Udhëzimit të MAS-së nr.30 datë 04.11.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr.599/3, datë 06.03.2023 “Kërkesë për rishpërndarje të fondeve buxhetore, shtesë në vitin 2023, për studentët e shkëlqyer të UMT-së, të cilët përfitojnë mbështetje financiare për programet e studimit të cilat përbëjnë prioritet kombëtar”, në mbledhjen e datës 28.03.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve buxhetore për vitin 2023, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETAR
ZAMIRA GJINI**

ANËTARË

VERA OSTRENI

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ